

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Prill 2024

**Tiranë, më 27 Maj 2024:** Gjatë muajit Prill 2024, rezultojnë të kenë hyrë, në territorin shqiptar, 1.403.480 shtetas shqiptar dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar një rritje me 20,8 %, krahasuar me Prill 2023.


1.402.260 shtetas shqiptarë dhe të huaj rezultojnë të kenë dalë nga territori i republikës së Shqipërisë, duke shënuar një rritje me 22,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Hyrjet e shtetasve

Në Prill 2024, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 609.351, duke pësuar një rritje me 11,3 %, krahasuar me Prill 2023.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 794.129. Ky numër është rritur me 29,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 (fig.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Prill 2023- Prill 2024



**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për publikim 27/05/2024

### Daljet e shtetasve

Në muajin Prill 2024, 613.196 shtetas shqiptarë numërohen të kenë dalë nga territori i Shqipërisë, duke shënuar rritje me 8.8 %, krahasuar me Prill 2023.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Prill 2024, janë 789.064. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky tregues është rritur me 35,2 % (tab.1).

**Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periudha	Prill 2023	Prill 2024	Ndryshimi vjetor %	Janar – Prill 2023	Janar – Prill 2024	Ndryshimi vjetor %
<b>Hyrje Gjithsej</b>	<b>1.161.729</b>	<b>1.403.480</b>	<b>20,8</b>	<b>3.537.070</b>	<b>4.565.231</b>	<b>29,1</b>
Shqiptarë	547.473	609.351	11,3	1.852.250	2.235.989	20,7
Të Huaj	614.256	794.129	29,3	1.684.820	2.329.242	38,2
<b>Dalje Gjithsej</b>	<b>1.147.154</b>	<b>1.402.260</b>	<b>22,2</b>	<b>3.637.536</b>	<b>4.798.435</b>	<b>31,9</b>
Shqiptarë	563.428	613.196	8,8	1.957.678	2.369.161	21,0
Të Huaj	583.726	789.064	35,2	1.679.858	2.429.274	44,6

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT*

Në Prill 2024, rajoni me numrin më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri është rajoni i Evropës me 753.973 shtetas, pasuar nga Amerika, Azia Lindore dhe Paqësori, përkatësisht me 16.699 dhe 5.301 shtetas (tab.2).

**Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj, sipas rajonit**

Periudha	Prill 2023	Prill 2024	Janar - Prill 2023	Janar - Prill 2024
<b>Gjithsej</b>	<b>614.256</b>	<b>794.129</b>	<b>1.684.820</b>	<b>2.329.242</b>
I. Afrika	803	2.006	2.278	5.088
II. Amerika	14.012	16.699	36.265	47.980
III. Azia Lindore dhe Paqësori	3.154	5.301	8.008	15.691
IV. Lindja e Mesme	1.526	1.246	2.954	3.303
V. Azia e Jugut	1.317	2.408	3.133	6.300
VI. Evropa	592.362	753.973	1.628.611	2.228.919
- Evropa Qëndrore / Lindore	21.034	29.935	49.863	99.406
- Evropa Veriore	19.977	31.909	50.036	88.500
- Evropa Jugore	490.116	598.675	1.400.223	1.832.911
- Evropa Perëndimore	44.329	64.440	86.679	140.741
- Evropa Lindore / Mesdheut	16.906	29.014	41.810	67.361
VII. Rajone të paspecifikuara	1.082	12.496	3.571	21.961

*Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT*

Në Prill 2024, krahasuar me Prill 2023, hyrjet e shtetasve të huaj shënojnë:

- rritje, për qëllime personale me 28,8 %;
- rritje, për qëllime pushime, vizitë tek të afërm, etj. me 30,6 %;
- rritje, për biznes dhe qëllime profesionale me 57,4 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Prill 2023	Prill 2024	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Prill 2023	Janar-Prill 2024	Ndryshimi vjetor (%)
<b>Hyrje shtetas të huaj</b>	<b>614.256</b>	<b>794.129</b>	<b>29,3</b>	<b>1.684.820</b>	<b>2.329.242</b>	<b>38,2</b>
<b>I. Personale</b>	<b>604.116</b>	<b>778.167</b>	<b>28,8</b>	<b>1.646.725</b>	<b>2.267.291</b>	<b>37,7</b>
1. Pushime, vizitë tek të afërm. etj.	572.670	747.992	30,6	1.566.134	2.171.458	38,7
2. Trajtime shëndetësorë	15	76	406,7	195	255	30,8
3. Qëllime fetare	43	23	-46,5	123	121	-1,6
4. Udhëtarë transit	31.388	30.076	-4,2	80.273	95.457	18,9
<b>II. Biznes dhe profesionale</b>	<b>10.140</b>	<b>15.962</b>	<b>57,4</b>	<b>38.095</b>	<b>61.951</b>	<b>62,6</b>

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

# Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

## Përkufizime

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë), Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve, Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet:** Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë), Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës, Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

**Vizitor:** Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

*Qëllime personale* të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare
4. Udhëtarë tranzit

*Kategoria e biznesit* që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm,

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm, Për më shumë referohu: [http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika e Revizionimit Statistikor,](http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/Politika_e_Revizionimit_Statistikor_)

**Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:**

- Ligjit nr,71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje.
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje.
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.